

Tiranë më 29.05.2025

KËRKESË ANKIMORE

Ankues: Ilir Alimehmeti, i biri i Mehdiut, lindur me 13.09.1979 në Tiranë, kandidatë nga lista shumë-emërore e Partisë Demokratike/Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD-ASHM).

Përfaqësuar nga Avokat Redon Meksi me nr. licence 5033 dhe NUIS L91308016L, Dhoma e Avokatisë, Tiranë, , me numer telefoni 0693737204 dhe adresë email redon.meksi@gmail.com dhe Avokat Ili Gërdupi me nr. licence 10146 dhe NUIS M22317006A, Dhoma e Avokatisë Tiranë, me numer telefoni 0695239156 dhe adresë email iligerdupi@gmail.com.

Me adresë për marrjen e njoftimeve: Meksi Law And Consulting, Rruga "Pjeter Bogdani" Ndërtesa 34/1, Hyrja 1

Lënda: Kundërshtimi i vendimit nr.1326 datë 24.05.2025 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025";

Rinumerimin dhe/ose rivlerësimi i votave në të gjitha KZAZ-t e Qarkut Triane;

Ndryshimi i rezultatit të tabelave përmbledhëse pas rinumerimit dhe/ose rivlerësimit të votave.

Drejtuar: Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Të nderuar!

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1326 datë 24.05.2025 ka miratuar tabelat përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Bashkëngjitur këtij vendimi në tabelën përmbledhëse të rezultatit për subjektin tonë zgjedhor rezulton se une, Ilir Alimehmeti, kam marrë 18128 vota si kandidat i listës së hapur, duke u renditur i dyti nga kandidatet e listes së hapur. Referuar numrit të përgjithshëm të votave të subjekteve sipas këtyre tabelave, nga listat e subjektit tonë zgjedhor mund të zgjidhet vetëm 1 deputet nga listat e hapura që referuar parashikimeve të Kodit Zgjedhor me ndryshimet e bëra së fundmi është kandidati më i votuar.

Gjatë procesit të verifikimit të filmimeve të kamerave nga ana jonë, për një numër të kufizuar të cilët na janë vendosur në dispozicion nga administrata e KQZ, janë vërejtur disa parregullsi të cilat mund të ndikojnë në ndryshimin e rezultatit në mënyrë tejet të ndjeshme. Në këto kushte po paraqes këtë ankim pranë KAS, bazuar edhe dispozitat e Kodit Zgjedhor që parashikon se:

Neni 124

E drejta e ankimit

1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit sipas nenit 98 të këtij Kodi mund të bëhet ankim në KAS brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit. KASshqyrton dhe vendos për ankimin e paraqitur brenda 48 orëve nga depozitimi i tij.

2. Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njësisve të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj, të marrë sipas nenit 122 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

3. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

4. Në çdo rast ankimi për pavlefshmëri, sipas nenit 160, dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria.

5. Të drejtën e ankimit, sipas pikës 1 të këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, si dhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, kundër refuzimit të kërkesave për akreditim të vëzhguesve, në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve. Vendimet e KQZ së për regjistrimin apo refuzimin për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, të marra në zbatim të pjesës IV të këtij Kodi, ankimohen sipas kreut I të pjesës XI të këtij Kodi në Kolegjin Zgjedhor.

6. Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KQZ-ja shqyrton të gjithë 72 problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor

Dëshiroj të theksoj se me anë të kërkesave të bëra me shkresën tonë datë 16.05.2025 dhe nr. 4540 prot., i jam drejtuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve që të më vendosë në dispozicion të gjitha filmimet lidhur me procesin e numërimit. Deri në këtë moment rezulton se nga ana e tyre këto të dhëna kanë qene të pjesshme. Pavarsisht kesaj, ne momentin paraqitjes së këtij ankimi rezulton se nga të dhënat e verifikuara deri tani, ndryshimet e rezultatit për çdo ZAZ midis atij të paraqitur në tabelën përmbledhëse të miratuar nga Komisioneri dhe rezultatit të verifikuar nga kqyrja e kamerave, shihet të jetë e konsiderueshme të votave midis kandidatëve, te mjaftueshme sa per te ndryshuar renditjen e ne Tabelen e Miratuar. Në këto kushte vlerësoj gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë ankimore, KAS duhet që në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të disponojë nëpërmjet marrjes së provave nga administrata e KQZ, duke u bazuar ndër të tjera edhe në parashikimet e K.Pr.A si më poshtë:

Neni 80

Kuptimi dhe mjetet e kërimit të provës

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:

a) të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;

b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;

c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.

2. Dispozitat e parashikuara ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

Duke u bazuar në kqyrjet e deritanishme rezulton se me një parregullsi në masën rreth 5% të votave të numëruara të konstatuara nga ana ime, duke patur parasysh faktit që subjekti ynë "PD-ASHM"

ka 164.316 vota, rezultati për kandidatët mund të ndryshojë, në kushtet që diferenca midis meje dhe kandidatit të renditur perpara ne liste është tejet e ngushtë ose rreth 1.2 % e numrit total të të gjitha votave të subjektit.

Vetem ne QV 1834/00, rezultojne se 27 vota preferenciale per Ilir Alimehmeti i jane kaluar nje tjeter kandidati, duke u shenuar ne tabelen permbledhese 0 vota.

Nga kqyrjet e deritanishme rezulton se rezultati ne QV-t e meposhtme jane te ndryshme nga ato te rezultatit te miratuar:

1. 1715/00
2. 1709/00
3. 1718/00
4. 1739/01
5. 1739/00
6. 1740/00
7. 1740/01
8. 1741/00
9. 1741/01
10. 1741/02
11. 1742/00
12. 1742/01
13. 1746/00
14. 1746/01
15. 1747/00
16. 1747/01
17. 1947/00
18. 1967/00
19. 1966/02
20. 1974/00
21. 2032/00
22. 2031/00
23. 2023/00
24. 2023/01
25. 2024/00
26. 2024/01
27. 2025/00
28. 2025/01
29. 2014/02
30. 2014/01
31. 2014/00




32. 2011/01
33. 2022/01
34. 2022/00
35. 2017/02
36. 1577/02
37. 1574/00
38. 1879/01
39. 1879/00
40. 1877/01
41. 1874/01
42. 1871/01
43. 1867/00
44. 1867/01
45. 1867/02
46. 1867/03
47. 1863/00
48. 1855/01
49. 1850/00
50. 1837/00
51. 1834/00
52. 1822/00
53. 1822/01
54. 1565/00
55. 1565/01

Qendrat e Votimit te mesiperme, krijojne bindjen se numerimi ka patur problematika ne te gjithë Qarkun e Tiranës, duke krijuar shkak per rinumerimin dhe/ose rivleresimin te te gjithave Qendrave te Votmit.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme përfundimisht,

KËRKOJ:

- Rinumerimin dhe/ose rivleresimin e te gjitha Qendrave te Votimit te Qarkut Tirane;
- Ndryshimin e Tabeles Permbledhese sipas rinumerimit dhe/ose rivleresimit te votave.



DR. ILIR ALIMEHMETI

Përfaqësuar me prokurë të posacme

AV. REDON MEKSI

Handwritten signature of Redon Meksi in blue ink, consisting of the name 'Redon Meksi' written twice in a stylized, overlapping manner.

AV. ILI GERDUPI

Handwritten signature of Ili Gerdupi in blue ink, featuring a stylized, flowing script.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SONILA A. XUKTHI
ADRESA NR.5, EMIN DURAKU,
NR.52, NR.1, NR.4
TEL:

PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 932

Nr. koleksioni: 462

Tirane më 27/05/2025

Ligjet referuesc:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



A2025052700054484847



A202305270005448484

PROKURË E POSAÇME

Sot, më datë 27/05/ 2025 , para meje Notere SONILA A. XUKTHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, EMIN DURAKU, NR.52, NR.1, NR.4, u paraqit personalisht:

I PERFAQESUAR: Ilir Alimehmeti, atësia Mehdi, amësia Jera, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Kongresi Manastirit; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 13/09/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034171966 dhe nr. personal H90913055W, .

I cili me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noterja redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

Autorizoj studion ligjore **"Meksi Law and Consulting"** me NIPT **L91308016L**, dhe ne emrin e Av. **Redon Meksi** me License nr. 5033, Av. **Edison Ademi** me License nr. 3908 dhe Av. **Ili Gërdupi** me License nr. **10146** të cilit i jap tagra dhe kompetenca të plota, të me përfaqësojë:

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe të gjitha trupave perberese të saj duke përfshirë por pa u kufizuar në Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, Kolegjit Zgjedhor, çdo Komision Zonal të Administrimit të Zgjedhjeve, si dhe çdo institucion tjetër të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve duke paraqitur kërkesa, ankime, opinione, parashtrime, dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm.
2. Të kërkojë të gjitha të drejtat e parashikuara nga Kodi Zgjedhor dhe Kushtetuta për kandidatet në zgjedhje të përgjithshme.
3. Të paraqitet para çdo gjykate organi publik apo privat, Personave Fizik ose Juridik , ku mund të kryejë çdo lloj aplikimi dhe veprimi për arritjen e qëllimeve të sipërpermendura.
4. Të me përfaqësojë në çdo Gjykatë kompetente të çdo niveli e shkalle, përfshirë Gjykatën Kushtetuese për të realizuar objektin e mesipër duke me përfaqësuar në çdo çilesi timen si pale për të arritur qëllimin për të cilin po e përpiloj këtë prokurë, të caktojë ekspert apo ti përjashtojë nëse e cileson të nevojshme për përfaqësim në keto gjykata, me të gjitha të drejtat që ligji njeh në keto raste.
5. Avokati ka të drejtë të me përfaqësojë në praninë ose mungesën time, së bashku ose vetë e vetë.

Avokatet kanë të drejtën:

-Të paraqitet para çdo organi publik apo privat, Personave Fizik ose Juridik , ku mund të kryejë çdo lloj aplikimi dhe veprimi në lidhje me sa më lartë (dorezim ose tërheqje dokumentacioni, aplikime etj)



A2025052700054184847

-Te me perfaqesojne ne çdo Gjykate kompetente te cdo niveli e shkalle per te realizuar porosite e mesiperme duke me perfaqesuar ne cdo cilesi timen si pale per te arritur qellimin per te cilin po e perpiloj kete prokure, te caktoje ekspert apo ti perjashtojte nese e cileson te nevojshme per perfaqesim ne keto gjykata, me te gjitha te drejtat qe ligji njeh ne keto raste.

-Te me perfaqesojne ne gjykime, te nenshkruajne kerkese padine dhe ç'do akt te nevojshem per gjykimet, ne gjykim, parashtrime, etj. Te depozitojne apo te terheqin dokumente te nevojshme prane institucioneve te ndryshme publike dhe jopublike , kudo ku do te jete e nevojshme persa une plotesoj kushtet per zgjidhjen e objektit te çeshtjes dhe deri sa vendimi perkates te marre forme te prere e perfundimtare ne favorin tim.

-Te ushtrojne te drejten e ankimit kunder vendimeve te ndermjetme e perfundimtare te çdo shkalle te gjyqesorit duke nenshkruar ne emrin tim, te ushtroje te drejten e apelimit e te rekursit, prapesime , te administrojne e te terheqin prova nqs do te linde nevoja te kerkoje ndryshim te trupit gjykues, eksperte, specialist apo dhe ti perjashtojne ata nga lista sipas rrethanave dhe fazave te shqyrtimit gjyqesor.

-Te ndjekin te gjitha te drejtat qe parashikohen, te ndryshojne objektin e padise, te kerkojne ndryshim te trupit gjykues, te bejne parashtrime, prapesime, te ngrejne kunderpadi, te kerkojne perjashtim gjyqtari, pushim gjykimi, pezullim gjykimi, nderhyres kryesore, etj.

-Te me perfaqesojne ne çdo maredhenie me te tretet.

-Te me perfaqesojne ne çdo institucion shteteror apo jo shteteror , zyra permbarimore e kudo ku e gjykon te arsyeshme.

- Te veprojne ne emer dhe per llogarine time, ne çdo institucion shteteror ose jo shteteror, kudo ku mund ti linde nevoja per te permbushur porosine objekt i kesaj prokure.

-Prokura do te jete efektive per nje afat kohor te pacaktuar, per arritjen e qellimit per te cilin e perpiloj, pa qene nevoja e rinovimit te saj, dhe per çdo revokim te mundshem te saj eshte pergjegjesia ime per ta njoftuar perfaqesuesit per te mos kryer veprime te metejshme. Të gjitha veprimet që do të kryejnë përfaqësuesit tane lidhur me të drejtën që iu kam dhënë i quaj të mirëqena sikur të ishin kryer prej meje personalisht.

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarës, e cila e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e saj të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres.

Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarës. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjerë për të përfaqësuarin.Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarës nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij.Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë



A20250527000544847

Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

(I/E) **PERFAQESUAR.** Ilir Alimehmeti

ILIR ALIMEHMETI

NOTER

SONILA A. XUKTHI



mb/lenr/surname
Alimehmeti
emil/given name
Alimehmeti
date of birth/nationality
Shqiptare/Albanian
year of birth/place of birth
Tirane, ALB
date of birth
18-09-1979
sex
M
date of issue
24-04-2019
signature

authorised officer/authority
MPB

date of expiry
23-04-2029
authorised officer/authority
H90913055W

